



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:289896
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05769244

C.nr.3311/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. H. nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Vlora Berisha, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 1,131.00 euro, jashtë seancës, me datë 21.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses S. H. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që t'ia kompensojë pagën e 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, duke llogaritur vlerën e shumës së pagës bazë prej 377.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 1,131.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuares së saj, më datë 20.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e pagës së 13-të, në vlerë të kontestit prej 1,131.00 euro.

Në padi ka theksuar se e njëjta është në marrëdhënie pune te e paditura në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, në pozitën e punës infermiere dhe realizon pagë bazë prej 377.00 euro. Bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale, ka konsideruar se i takon realizimi i pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa e paditura nuk ka kryer obligimin që i del nga KKS. Ka theksuar se i është drejtuar me kërkesë paraprakisht të paditurës si nivel i sistemit shëndetësor parësor me obligim për kompensimin e kësaj page, por e njëjta nuk i ka kthyer përgjigje. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumës prej 1,131.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 21.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë ka qenë në fuqi deri më datë 11.06.2021, prandaj nuk prodhon më efekt juridik. Ka vlerësuar se kërkesëpadia është e parashkruar, pasi është paraqitur pasi kanë kaluar më tepër se 3 vite. Për më tepër, kompensimi i pagës së 13-të, ka shtuar se realizohet sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, ndërsa në rastin konkret QKMF nuk ka pasur planifikim buxhetor për pagesën e pagës së 13-të, andaj edhe një pagesë e tillë nuk është realizuar. Realizimi i pagës së 13-të nuk është i karakterit detyrues, por devolutiv, në bazë të mundësive buxhetore, për çka edhe nuk janë paraqitur këto mundësi. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 399, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura (fakt i provuar nga kontrata në kohë të pacaktuar e lidhur mes paditëses dhe të paditurës, nr.04-1743 e dt.29.12.2016) dhe paga bazë e saj është 377.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses nga BRK).

Në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, në nenin 17, paragrafi 2 është përcaktuar se “Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Zbatimi i KKS-së, aplikohet për periudhën 11.06.2018 – 10.06.2021, ndërsa mos realizimi i pagës së 13-të, justifikohet vetëm nëse punëdhënësi provon se në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi buxhetore për të kompensuar këtë pagë. Pra, barrën e të provuarit për mundësitë buxhetore e bart punëdhënësi.

Ky interpretim është në harmoni edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.212/2023 të datës 09.10.2023.

Për të provuar mundësitë buxhetore të të paditurës, gjykata ka administruar provën: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2020, i publikuar në Prishtinë, Qershor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Sa i përket Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2020, të publikuar në Prishtinë, Qershor 2021 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, në faqen 20, pikën 3 shihet se është konstatuar se “në vitin 2020, Komuna e Gjilanit ka shpenzuar 93 % të buxhetit përfundimtar, ose 27,361.357 euro, me një ulje 1 % në krahasim me vitin 2019”. Në ekstraktin tabelar shihet se në vitin 2020 për kategorinë pagat dhe mëditjet, buxheti final ka qenë 15,929,937 euro, ndërsa shpenzimet kanë qenë 15,816,156 euro.

Nga kjo konstatohet se për 113,781 euro, nuk është shfrytëzuar buxheti final nga e paditura sa i përket kategorisë pagat dhe mëditjet.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, vlerësoi se raporti i auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka fuqinë provuese të saktësisë së të dhënave në të, prandaj të njëjtës gjykata ia falë besimin e plotë.

Gjykata vlerëson se në këtë rast e paditura e ka provuar se nuk ka pasur mundësi buxhetore për kompensimin e pagës së 13-të, për të punësuarit e saj, ndërsa meqë ky kompensim realizohet vetëm në bazë të mundësive buxhetore, gjykata e refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses.

Faktin se e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore për këtë kompensim, gjykata e vërtetoi nga dokumentet e theksuara si më sipër, nga të cilat konstatoi se e paditura për vitin 2020 në kategorinë pagat dhe mëditjet sipas buxhetit final dhe atij të shpenzuar ka pasur suficit prej 113,781 euro.

Kjo shumë, gjykata vlerëson se nuk paraqet mundësi buxhetore të mjaftueshme për kompensimin e pagës së 13-të, pasi përbën një shumë që në asnjë mënyrë nuk arrin të kompensojë të gjithë të punësuarit e saj, me ç'rast provon se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për këtë kompensim.

Thënë këtë, gjykata vlerëson se është justifikuar mos kompensimi i pagës së 13-të, në mungesë të mundësive buxhetore, pasi sipas bindjes së lirë së gjykatës nga faktet e paraqitura në padi dhe në përgjigje në padi, shqyrtimi dhe analizimi i raportit të auditimit, vlerësohet se suficiti prej 113,781 euro, nuk paraqet mundësi buxhetore mbi bazën e së cilës mund të kompensohet paga e 13-të, për të punësuarit e të paditurës.

Gjykata për kompensimin e pagës së 13-të, shqyrtoi dokumentet përkatëse vetëm sa i përket vitit 2020, pasi e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës dhe bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, kërkesa e paditëses sa i përket vitit 2018 dhe 2019 është e parashkruar.

Në nenin 87 të Ligjit të Punës është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjen zbatim neni 87 i LP-së, pasi kërkesa e paditëses është kërkesë monetare, e cila është paraqitur më datë 20.12.2023, ndërsa parashkruhet prej 3 vite nga data e paraqitjes së kërkesës, pra më datë 20.12.2020. Prandaj, kompensimin e pagës së 13-të, për vitin 2018 dhe 2019 gjykata e gjeti të parashkruar.

Nga kjo arsye, gjykata vendosi të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, pasi përkundër suksesit të të paditurës në procedurë, e njëjta nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.3311/23, datë 21.05.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.